



Datë/a:	01.04.2021
Për/ Za/ To:	DWH – Kosova SHPK
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Aktivitetit të Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 30.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik DWH – Kosova SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operator Ekonomik DWH – KOSOVA SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 15.03.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së. të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 15.03.2021 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111.

Me datë 30.03.2021, **Operator Ekonomik:** DWH – KOSOVA SHPK ka bërë kërkesë për rishqyrtim me c’rast ka kërkuar që tu ipen përgjigje në tri pyetjet e parashtruara si në vijim:

Fakte dhe detaje 1. LPP 04/L-042, neni 1 detyron AK, te beje gare sa me te hapur. ky ligj dhe nen eshte shkelur i pari. Ne ju kemi kerkuar te na vini ne dispozicion datasheet-et e produkteve, qe ju ne fazen e pregatitjes se specifikimeve teknike, keni konsultuar dhe kualifikuar si te mireqena. Kerkesa jone nuk ka marre pergjigje. Ne kerkojme qe te ndryshoni specifikimet teknike, duke perdorur: 1. Gjuhe teknike te datasheet-eve 2. Te hiqni kerkesat desherore, qe nuk gjejne mbeshtetje ne ligj dhe/ose i kundervihen ligjit. 3. te na dorezoni datasheet-et, qe ju keni konsultuar dhe kualifikuar ne pregatitjen e specifikimeve teknike!

Baza Ligjore

A.K (njësia kërkuese) sipas dispozitave të L.P.P.K-së është autoritet kompetent për hartimin e specifikave jo diskriminuese sipas nevojave të A.K.

Gjuha e përdorur në hartimin e specifikave teknike është mjaftë profesionale.

O.E. nuk ka të drejt të ja imponoj A.K hartimin e specifikave gjë që do të rezultonte në diskriminim të aktivitetit. Këto janë nevoja të A.K. dhe këtu nuk shohim as edhe një specifikim dëshiror.

Njësia e kërkesës në konsultim me stafin profesional të autoritetit kontraktues si dhe kërkimeve -hulumtimeve në internet ka bërë hartimin e specifikave sipas nevojave të A.K.

Specifikimet teknike janë të publikuara në sistemin elektronik të e-prokurimi të cilat janë të qarta.

Njësia kërkuese i rekomandon O.E të i referohet specifikimeve në sistemin e-prokurimi si dhe vendimit të dates 23.03.2021

Përgjigjet në pyetjet tuaja i gjeni edhe në vendimin 23.03.2021 të A.K.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

